

Radhës së atyre që kanë reaguar për arrestimin e hoxhës Shefqet Krasniqi, ka qenë edhe hoxhë Ulvi Fejzullahu. Në një postim në profilin e tij në facebook, ai ka akuzuar politikën kosovare për “spektaklin” e krijuar me arrestimin e hoxhës Shefqet Krasniqit.

Në vazhdim mund ta lexoni të plotë reagimin e hoxhës Ulvi Fejzullahu.

*O politikan politikbërës kosovare: “Juve as qentë nuk ju hanë!”*

*Ama, pse bien në këtë nivel e derexhe politika kosovare...!!, pa fije morali e turpi, në mënyrë të lirë mund të shprehesh vërtetë këta janë “nona e qenve”. Kur këta e kanë këtë status, pra “nona e qenve”, pastaj këta të “jashtit”, njëmend me jashtëqitje, janë “nona kudrave”.*

*Po pse bien këta të tanët, bash në këtë derexhe, nuk kisha ditë me e menduar tamam kështu siç janë.*

*Tani po rikujtoj një ndodhi të kamotshme.*

*Baba një djalë, por, jo i rehatshëm. Po vonohet natën në kafën poshtë fshatit. Një natë e hanë qentë. Kështu vjen i përgjakur në shtëpi, alarmon rastin. Kurse babai në atë gjendje i thotë birit: mirë është puna, djali im, unë kam menduar që ty as qentë nuk t'hajnë.*

*Këta politikanë politikbërës, definitivisht as qentë juve nuk ju hajn, aq që jeni fekale.*

*Allahu na ruajt prej sherrit tuaj.*

*Allahu e ruajt dr. Shefqetin dhe çdo të pafajshëm besimtarë.*

*Ulvi F.*